



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Nr. 2289 / Prot
1

Tiranë, më 21/09 /2020

Lënda: Njoftim për vend të lirë pune

DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 “Për nxitjen e Punësimit”, Ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, të Udhëzimit nr. 11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”, Urdhërit nr. 107, datë 13.08.2020 “Për disa ndryshime në Urdhërin nr.172, datë 24.12.2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive” dhe shkresës nr.778 prot, datë 15.09.2020 “Njoftim për vend të lirë pune ” të Shkollës së Mesme Profesionale “Kristo Isak” Berat, protokolluar pranë AKPA-s me nr.2289 prot, datë 17.09.2020, ju lutem procedoni me shpalljen e njoftimit për vendin e lirë në portalin e AKPA-së, brenda datës 22.09.2020, si më poshtë:

Pozicionet e punës:

- 1 mësimdhënës i formimit praktik në drejtimin Hoteleri-Turizëm

1. Kritere të përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

2.Kritere të posaçme për personelin mësimdhënës të formimit praktik në Shkollën e Mesme Profesionale “Kristo Isak” Berat

- a) të ketë diplomë nga një shkollë e mesme profesionale ose të nivelit *bachelor* në një nga profilet, që lidhet me zhvillimin e kurrikulës së kulturës profesionale të ofruesit të AFP-së;
- b) të ketë të paktën 5 (pesë) vjet eksperiencë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;

c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

3. Dokumentet e aplikimit

a) letër motivimi për pozicionin;

b) jetëshkrimin (CV-në), i cili plotësohet sipas formatit *Europass* në shtojcën 1, të Udhëzimit nr. 11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”,

c) të dhënat e aplikuesit, të plotësuara sipas modelit të përcaktuar në shtojcën 2, të Udhëzimit nr. 11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”,

d) fotokopje të kartës së identitetit, fotokopje të diplomës dhe fotokopje të librezës së punës;

e) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;

f) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;

g) vërtetim të gjendjes shëndetësore;

h) vërtetim të gjendjes gjyqësore;

i) vërtetim nga punëdhënësit e mëparshëm, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;

j) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e Shkollës së Mesme Profesionale “Kristo Isak” Berat, brenda datës 01.10.2020.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

